



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ÇËRRIK

Date 01.11.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: *“Ndërtim Kuz dhe rikonstruksion i rruges se Rrasave e Kabashi në shtermen ”*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi për rrugë-45233120-6 - Punime ndërtimi për rrugë dytësore -45233123-7

VLERA E FONDIT LIMIT: **23038684** (njezete e tre milion e tridhjetë e tete mije e gjashtëqind e tetëdhjetë e kater)lekë pa TVSH .

Argumentimi i fondit limit: Perlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike eshte kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre nr.625 datë 15.07.2015,(ndryshuar me VKM-në nr.631,datë 26.10.2018 ,si dhe ne aktin normativ nr.10 date 18.05.2022” Per kompesimin financiar te cmimit per disa materiale ndertimi sipas percaktimit te kontrates per pune publike si pasoje e situates se vecante te krijuar ne treg gjate vitit 2022” me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Cerrik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i Ofertës sipas shtojcës 1 dhe 2.*

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% se fondit të venë në dispozicion.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është e hapur , përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa ”b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”, Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij., VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 ”Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2019, 2020, 2021), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Te shoqeruara nga Ekspert Kontabel i autorizuar në përputhje me ligjin nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimi ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar.”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat

tatimore : Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2022 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësi/a/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, nenit 39 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e kërkesës për detyrimet vendore për vitin 2022 është bërë në mbështetje të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.(sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet). Shlyerja e detyrimeve vendore për operatorët ekonomik pjesëmarrës vërteton se ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në përputhje me rregullat e përcaktuara nga autoritetet vendore nëpërmjet Vendimeve të tyre të Këshillave Bashkiak.

2.3. Kapaciteti teknik:

Lidhur me kapacitetet/aftësinë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

2.3.1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- Për kontrata të realizuara me ente/institucione publike, OE duhet të paraqesë:

- Formularin e vlerësimit, sipas shtojcës 9, shoqëruar me:
- Kontratën/at e sipërmarrjes;
- Situacionin përfundimtar të objektit;
- Aktin e kolaudimit;
- Certifikatën e marrjes në dorëzim (të përkohëshme/përfundimtare)
- Për kontrata të realizuara me sektorin privat, OE duhet të paraqesë:
 - Formularin e vlerësimit, sipas shtojcës 9, shoqëruar me:
 - Kontratën/at e sipërmarrjes;
 - Situacionin përfundimtar të objektit;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Faturën/at tatimore

Në rast se oferta paraqitet nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, pika 2.3.1, gërma “a”, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1, gërma “b”, duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2. Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë dhe të paraqesë Licencën profesionale të shoqërise për realizimin e punimeve objekt kontrate, e cila duhet të përmbajë së paku kategoritë e mëposhtëme:

N.P-1 A, Punime germimi ne toke

N.P-4 B, Rruge,autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale

N.P-5 A, Punime nentokesore, ura e vepra arti

N.P-6 A Sinjalistika rrugore jo ndricuese

N-P -7A Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje.

N.S-18 A Punime topogjeodezike

N.S-19 A Sistemimi i mbrojtjes nga zhurmat ne infrastrukture

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Për Operatorët e huaj të bëhet ekuivalentimi/njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit kompetent të autorizuar, në plotësimin e licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ndryshuar ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”.*

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve të këtij objekti, si më poshtë:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- *N.P-1A Punime germimi ne toke*

Referuar Preventivit janë parashikuar kryerja e punimeve të gërmimit, si pjesë seksioni e veçantë. Referuar lidhjes 3 të VKM 42/2008 parashikohet se “N.P. I Punime gërmimi në tokë Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore”.

- *NP- 4 B Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.*

Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

PËR PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

Referuar Lidhjes 4 të VKM 42/2008 parashikohet se Klasa A për punime me vlerë 0- 20 milion lekë- në proporcion me fondin limit.

- *N.P-5 A - Referuar lidhjes 3 të VKM 42/2008 parashikohet se: konsiderohen Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut*
- *N.P-6 A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese parashikohen zera ne preventivin fillestarne sesioni 11 e perkatesisht zerat 1,2,3,4 .*
- *N-P -7 Ne preventivin fillestar percaktohen volume konkrete pune*
- *per kete kategori, vet objekti i prokurimit ka te beje me kanale te ujerave te zeza, konkretisht ndertimi i rrjetit KUZ ne NJ.A Gostime*
- *NS 18 B Punime topogjeodezike*

Referuar lidhjes 3 të VKM 42/2008 parashikohet se: NS 18 B Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

- N.S-19 A *Sistemimi i mbrojtjes nga zhurmat ne infrastrukture*

2.3.3. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 52 (Pesdhjete e dy) punonjës të siguruar, për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për secilin muaj të kërkuar;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentim: *Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për numrin e punonjësve duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Punonjësit janë kërkuar në proporcion me volumet e punës sipas manualeve perkatëse.

2.3.4. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme dhe diplomë,

të figurojnë në licencën profesionale të shoqërisë në zbatim, si dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, si mëposhtë:

- 1 (nje) inxhinier ndërtimi
- 1 (nje) inxhinier elektrik
- 1 (nje) inxhinier mekanik
- 1 (një) inxhinier elektronik
- 1 (një) inxhinier hidroteknik
- 1 (një) inxhinier Topograf

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve.*

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për rikonstruksionin e rrugës, zbërthimin e projektit të zbatimit, punimet e shtresave me çakull, zhavor, stabilizant, binder dhe asfaltobetoni etj. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve si p.sh çakull, zhavor, stabilizant, binder dhe asfaltobetoni etj.
- **Inxhinieri elektrik** është i nevojshëm për zbatimin e saktë të punimeve elektrike, konkretisht për punimet e ndricimit referuar zërave të preventivit ne sesionin 2 zerat 1,2 dhe zbërthimin e projektit.
- **Inxhinier Hidroteknik:** Ne preventivin fillestar percaktohen volume konkrete pune te domosdoshme per tu ndjekur nga inxhinieri hidroteknik persa i perket volumit te pergjithshem te parashikuar ne preventive e perkatesisht ne sesionin 10 zerat 1,2,3,4..10,11.
- **Inxhinier Mekanik :** E kemi kerkuar kete inxhinier per arsye se mund te kete problematika gjate zbatimit te punimeve dhe mund te kete ndryshime dhe rregullime te cilave mund ti pergjigjet gjate zbatimit inxhinieri perkates. Si dhe eshte e domosdoshme asistenca e inxhinierit per çdo defekt te mundshem te mjeteve qe do te perdoren gjate zbatimit te punimeve
- **Inxhinier Gjeodet/Topograf :** është përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit objekt prokurimi.

2.3.5. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:

- Mjek, 1 të punësuar. Kontratë noteriale të punës , diplomë, licence si dhe CV.

- 2 (dy) Punonjës me dëshmi trajnimi si “Specialist për sigurinë dhe shëndetin në punë”. Kontratë noteriale të punës si dhe certifikatë trajnimi “Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”.
- 2 (dy) Specialiste të certifikuar për punime në lartësi. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune noteriale, si dhe dokumentin e perkates te certifikimit
- 2 (dy) Inspektor Cilesie me background Inxhinierik me mbi 5 vite eksperience pune si Inspektor Cilesie ne perputhje me standartin ISO 9001:2015., i cili duhet te figuroje ne listepagese e shoqërisë per periudhen nentor 2020-janar 2021.Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune noteriale, si dhe dokumentin e perkates te certifikimit
- 1 (nje) person te certifikuar si “Pergjegjes per demet ne mjedis” gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune noteriale, si dhe dokumentin e perkates te certifikimit
- 2 (dy) specialist ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpëtimin ne mbështetje te pikës 4 tr nenit 49 te Ligjit Nr.152/2015 “Per shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpëtimin”. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune noteriale, si dhe dokumentin e perkates te certifikimit.
- 1 (nje) auditues energjie. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune noteriale, si dhe dokumentin e perkates te certifikimit
- 1(nje) inxhinier gjeolog me profil gjeofizike. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune noteriale, si dhe diplomen perkatese.
- 3 (tre) Automakiniste shoqëruar me kontratë pune noteriale, leje drejtimi (te vlefshme) te leshuar nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor
- 4 (kater) eskavatoriste shoqëruar me kontratë pune noteriale, leje drejtimi (te vlefshme) te leshuar nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor
- 4 (kater) buldozeriste shoqëruar me kontratë pune noteriale, leje drejtimi (te vlefshme) te leshuar nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor
- 2 (dy) Shofere kamioni - te pajisur me kontrate pune noteriale dhe deshmi te aftesise profesionale te leshuar nga Ministria e Transportit (Certifikate Aftesimi Profesional)
- 3 Shofere me patente kategoria C shoqëruar me kontrate pune noteriale dhe leje drejtimi kategoria C.
- 3 Inxhinier ndertimi shoqëruar me diplome, kontratë pune noteriale.
- 2 Teknike Elektriçist shoqëruar me diplome/deftese, kontratë pune noteriale dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ISHTI
- 2 Teknike mekanik shoqëruar me diplome/deftese, kontratë pune noteriale dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ISHTI,
- 2 Teknik ndërtimi shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe diplome/deftese.
- 2 Saldator shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikate deshmie perkatese te kualifikimit profesional (deshmi profesionale)
- 2 specialiste per ndihmen e shpejte, shoqëruar me kontrate pune noteriale dhe certifikate nga Kryqi i Kuq Shqiptar
- 3 (tre) hekurkthyes shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikate deshmie perkatese te kualifikimit profesional (deshmi profesionale)
- 3 (tre) karpentiere shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikate deshmie perkatese te kualifikimit profesional (deshmi profesionale)
- 2 (dy) saldatore shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikate deshmie perkatese te kualifikimit profesional (deshmi profesionale)

- 2 (dy) specialiste montim tubash hdpe shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikate deshmie perkatëse te kualifikimit profesional (deshmi profesionale)
- 2 (dy) hidraulike shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikate deshmie perkatëse te kualifikimit profesional (deshmi profesionale)

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Stafin e punonjësve te specializuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar. Punëtorët e specializuar (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtoare) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë punëtoare te specializuar sipas pikës 6, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit. Referuar VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

2.3.6. Operatori Ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Mjetet	Sasia	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min.10 ton	2 copë	Ne pronesi ose me qera
2	Kamionçinë 3-5 ton	3 copë	Ne pronesi ose me qera
4	Eskavatore	3 cope	Ne pronesi ose me qera
5	Fadroma	1 cope	Ne pronesi ose me qera
6	Asfaltoshtrueses	1 cope	Ne pronesi ose me qera
7	Autobitumatrice	1 cope	Ne pronesi ose me qera
8	Makineri skarifikim asfalti	1 cope	Ne pronesi ose me qera
9	Grejder	1 cope	Ne pronesi ose me qera
10	Rrul ngjeshes	2 cope	Ne pronesi ose me qera
11	Rrul vibrues	4 cope	Ne pronesi ose me qera
12	Autobetoniere	3 cope	Ne pronesi ose me qera
13	Autopome betoni	2 cope	Ne pronesi ose me qera
14	Fabrikë betoni shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë, planin e vendosjes dhe lejen mjedisore Kodi: III.1.B, lëshuar nga Qendra	1	Në pronësi, qira ose kontratë noteriale furnizimi

	Kombëtare e Licencimit ose leja mjedisore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit.		
15	Fabrike asfalti e pajisur me leje mjedisore	1	Në pronësi, qira ose kontratë noteriale furnizimi
16	<i>Pompë suvatimi</i>	<i>3 copë</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
17	<i>Gjenerator</i>	<i>1 copë</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
18	<i>Depozitë uji 3.000-5.000 litra</i>	<i>2 copë</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
19	<i>Autovinç</i>	<i>2 copë</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
20	<i>Skela dhe rrjetë mbrojtëse</i>	<i>500m2</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
21	<i>Vibrator</i>	<i>2 copë</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
22	<i>Autobot uji</i>	<i>1 copë</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
23	<i>Betoniëre kantieri 1.5-3 m3</i>	<i>2 copë</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
24	<i>Vinç karele</i>	<i>1 copë</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
25	<i>Matrapik</i>	<i>2 copë</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
26	<i>Nivelues betoni</i>	<i>1 copë</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
27	<i>Minieskavator</i>	<i>1 copë</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
28	<i>Termometer per matje togezimi</i>	<i>1 copë</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve dhe personelit, si më poshtë:

1. Kokore, minimumi 90 copë.
 2. Ripa lidhës sigurimi për punime në lartësi, minimumi 30 copë.
 3. Komplet i ndihmës së shpëjtë, minimumi 5 copë.
 4. Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt, minimumi 20 copë.
 5. Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 3 copë.
 6. Proxhektorë ndriçimi natën, minimumi 4 copë.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë në pronësi, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon: -certifikata e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikata e kontrollit teknik; -polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); -leje/certifikata e transportit të mallrave për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
 - Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë të disponuara me qira, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon: -kontrata noteriale e qirasë; -certifikata e pronësisë së qiradhënësit; -leja e qarkullimit; -certifikata e kontrollit teknik; -polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); -leje/certifikata e transportit të mallrave për të tretë dhe me qira për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
 - Për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata noteriale e blerjes / akt-zhdoganimi / faturë tatimore / çdo dokument që vërteton fitimin e pronësisë mbi sendin sipas Kodit Civil të RSH. Ndërsa për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera të disponuara me qira ose kontratë noteriale furnizimi, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë e vlefshme.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga projektuesi. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapesirat fizike rreth objektit mundesive te manovrimit me mjete te renda.

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me leje/licencë të lëshuar nga QKL/QKB, Kodi III.2.B, lidhur me transportimin e mbetjeve që kanë ndikim në mjedis.

Argumentimi : Kërkesa e mesiperme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/B të këtij ligji”.

Në shtojcën I/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën **për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

2.3.8. Shoqëritë e huaja duhet te kene kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktues, Republika e Shqipërisë, sic percaktohet ne Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008.

- Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë për cilësinë së punimeve **ISO 9001** (e vlefshme).
- Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001** (e vlefshme).

- Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë, **OHSAS 18001 ose 45001** (e vlefshme).
- Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë për sistemin e intergruar , **PASS 99** (e vlefshme).

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë certifikatat ISO sipas zëravë të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes.

Certifikatat ISO duhet të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 mbi " Sistemet e menaxhimit te cilesise " ekuivalente e vlefshme

Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi , e cila mundeson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës.

ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit te ambientit “ ekuivalente e vlefshme

Eshtë standarti më i përdorur në botë për sistemet e menaxhimit të mjedisit. Rikonstruksioni I objektit konkret, përveçse kërkojnë një kapacitet me makineri kanë edhe një ndikim në mjedis për shkak të kushteve në të cilat realizohen si ndotja e ajrit nga pluhurat e kantieritn ndotja akustike dhe mjedisore nga makinerit etj, Për këtë arsye cdo operator ekonomik duhet të jetë i certifikuar për menaxhimin e ambientit. Eshtë në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

ISO 45001:2018 mbi “Standart per menaxhimin e rrisqeve rreth shendetit dhe sigurimit ne pune” ekuivalente e vlefshme

Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes mundeson qe çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Çertifikatë për sistemin e intergruar , PASS 99 Përcakton specifikimet e disponueshme publikisht për integrimin e sistemeve të përbashkëta të menaxhimit, të cilat janë dizenuar për të përmirësuar mënyrën e funksionimit të bizneseve që mund të kenë strukturë të ngjashme. Është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

2.3.9. Ofertuesi duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin teknik të punimeve në objekt, i cili do të jetë i pranishëm çdo ditë në objekt , të përfshirë në licencën e shoqërisë , shoqëruar me dokumentat e mëposhtme:

- i. CV përkatëse.
- ii. Kontratë pune të vlefshme.
- iii. Diplomë

2.3.10. Ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim të administratorit të shoqërisë ku deklaron se Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara. (Sipas shtojcës 10 të DST)

Argumentimi : Përcaktimi i kërkeses për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetem për angazhimin tere kohen e kryerjes se punimeve te nje drejtuesi teknik te shoqerise por dhe si orientim për nje person kontakti dhe ure lidhese mes mbikqyresit te punimeve dhe AK për problematiken qe do te haset gjate realizimit te punimeve.

2.3.11. Në përputhje me specifikimet teknike dhe preventivin ofertuesi duhet të paraqesë autorizim / kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/ distributor i autorizuar shoqëruar me certifikate cilesie ISO 9001 2015 te vlefshme ose ekuivalente me të cilin me të cilin prodhuesi / distributori i autorizuar, autorizon ofertuesin të ofertojë këto mallra në këtë procedurë prokurimi:

1. Pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086
2. Ndriçues Smart VP CL1 CR M-S 250W GG FAE 44004 me llampe 50A let
3. Bordura betoni 15x30 cm

2.3.12. Ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim të administratorit të shoqërisë ku deklaron që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent.

2.3.13. Ofertuesi duhet të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e punimeve

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike jane sipas shenimeve ne projektet perkatese, bashkelidhur dokumenteve te tenderit, te hartuara nga projektuesit.

NJESIA E PROKURIMIT
